

VENDIM
Nr.491, datë 6.7.2011

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË, TË PASURISË ME SIPËRFAQE 16 HA, NË ZONËN KADASTRALE NR. 2488, FSHATI LOHE E SIPËRME NË KOMUNËN SHKREL TË QARKUT TË SHKODRËS, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.406, DATË 8.4.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA SHKREL E QARKUT TË SHKODRËS”, DHE NR.1524, DATË 19.11.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME NË KOMUNËN SHKREL TË QARKUT TË SHKODRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pronës së paluajtshme me sipërfaqe të përgjithshme 16 (gjashtëmbëdhjetë) ha, në zonën kadastrale nr.2488, e ndodhur në fshatin Lohe e Sipërme në komunën Shkrel të qarkut të Shkodrës, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e Qendrës së Paraburgimit dhe të Burgut, Shkodër.

2. Sipërfaqja prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) ha, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, përmendet në faqen 21, në zërin kadastral tokë – arë, të listës së inventarit, bashkëlidhur vendimit nr.1524, datë

19.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme në komunën Shkrel të qarkut të Shkodrës”.

3. Sipërfaqja prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) ha, e cila ndodhet e përfshirë edhe në pasurinë e listuar me nr.121, me përshkrimin “Ekonomi pyjore dhe kullotë, Bzhetë – Dedaj në komunën Shkrel të qarkut Shkodër”, hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.406, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave.

4. Ndalohen tjetërsimi, dhënia në përdorim apo ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe komuna Shkrel e qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha